



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

20 -08- 2024

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 01/1216-2024



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA KLINË  
MUNICIPALITY OF KLINA  
KLINA KLINA

Nr.No.Br. 013-20739/24

Data-Data-Éndërti 27.08.2024

Klinë-Klina

## MARRËVESHJE BASHKPUNIMI


NË MES

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)

DHE

KOMUNËS SË KLINËS

LIDHUR ME ZBATIMIN DETYRIMEVE LIGJORE QË DALIN NGA  
LIGJI NR.08/L-228 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË  
REPUBLIKËN E KOSOVËS



## Neni 1


### Qëllimi

Marrëveshja e Bashkëpunimit ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore që dalin me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Komunën e Klinës, në ofrimin e mbështetjes Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) gjatë dhe pas procesit zgjedhor.

## Neni 2

### Përgjegjësitë e Komunës

1. Komuna në përmbushjen e përgjegjësive ligjore, sipas nenit 68, paragrafi 5 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme, është e obliguar që t'i ofrojë mbështetjen e nevojshme KKZ në kuptimin e sigurimit të hapësirave për punë, depo për materiale, transport, objekte publike për nevoja të votimit apo ambiente tjera për organizimin e trajnimeve të komisionarëve dhe numëruesve, si dhe hapësira për adaptimin e Qendrave Komunale të Numërimit (QKN).
2. Sigurimin e hapësirave për punë të KKZ, brenda objekteve të administratës komunale për kryerjen e detyrave të veta, me kycje në rrjetin qeveritar të internetit, sistemin e ftohjes dhe ngrohjes, higjienë, mirëmbajtjen e brendshme të hapësirës /zyrës dhe shërbimet e tjera komunale.
3. Sigurimin e Transportit për KKZ gjatë procesit zgjedhor për nevoja të KKZ.
4. Sigurimin e objekteve publike për nevoja të votimit, që përfshin shkollat dhe hapësirat tjera të administratës komunale.
5. Sigurimin e ambienteve dhe hapësirave tjera për organizimin e trajnimeve të komisionarëve dhe numëruesve.
6. Sigurimin e hapësirave për përdorim dhe adaptimin e tyre si QKN para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, për pranimin, shpërndarjen e materialit, kthimin e materialit në QKN, verifikimin dhe numërimin e materialit zgjedhor nga qendrat e votimit para se materiali të dërgohet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).
7. Për QKN, përveç hapësirës, komuna duhet të sigurojë që të jetë funksional sistemi i ftohjes/ngrohjes, të ketë energji elektrike pa ndërprerje, të ketë inventarin e nevojshëm, internetin, infrastrukturën hidrosanitare, hapësirën e mjaftueshme për parking, etj. sipas kritereve të përcaktuara nga KQZ.



8. Ofrimin e mundësive të barabarta për personat me nevoja të veçanta, në mënyrë që ky komunitet të ketë qasje nëpër objektet ku mbahen zgjedhjet, aty ku ka mundësi.
9. Ofrimi i ndihmës tjetër të nevojshme të kërkuar nga KQZ-KKZ.

### **Neni 3**

#### **Përgjegjësitë e KQZ**

1. KQZ është e obliguar që objektet e shfrytëzuara si zyra pune, qendrat e votimit, sallat dhe lokalet për trajnim, QKN, t'i ruajë dhe shfrytëzojë vetëm për organizimin e procesit zgjedhor.
2. KQZ do t'i sigurojë Komunës pasqyrën për qendrat e votimit dhe vendndodhjen e tyre.
3. KQZ do të sigurojë që asnjë palë e tretë të mos ketë qasje në objektet e shfrytëzuara nga KQZ.
4. KQZ, nëpërmjet KKZ, është e obliguar që t'i koordinojë aktivitetet që lidhen me shfrytëzimin e hapësirave për votim, numërim dhe trajnim në mes të KQZ dhe Komunës së Klinës.

### **Neni 4**

#### **Dispozitat përfundimtare**

1. Për realizimin e përgjegjësive që dalin nga kjo marrëveshje e bashkëpunimit, palët pajtohen që të njoftojnë njëra-tjetrën në çdo kohë.
2. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit do të aplikohet derisa palët reciprokisht me shkrim nuk merren vesh ndryshe.
3. Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, shkelje, ndërprerje apo pavlefshmëri do të zgjidhet me mirëkuptim dhe partneritet.
4. Me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, krijohen obligime të ndërsjella të palëve për realizimin e detyrave të tyre.

### **Neni 5**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja palët, shtypet në dy kopje të barasvlefshme, nga një për secilën palë.

Prishtinë, 20/08/2024

**Palët nënshkruese të marrëveshjes:**

Kreshnik Radoniqi

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Zenun Elezaj

Kryetar i Komunës së Klina